

**Tabelë metodike për organizimin e informacionit mbi Transhumancën  
si element i trashëgimisë jomateriale  
Methodological table for organizing information on Transhumance  
as an ICH element**

<b>1. Identifikimi i elementit të TKJ/ Identification of the ICH element</b>
<p>1.1. Emri i elementit ashtu siç përdoret nga bashkësia/ Element name as used by the community</p> <p>Shtegtim, bjeshkënim (Transhumancë)</p>
<p>1.2. Titull i shkurtër dhe informativ i elementit të TKJ (së bashku me treguesin e fushëveprimit (ve) përkatës)/ Short and informative title of the ICH element (together with the relevant scope indicator (s))</p> <p>Transhumanca në Shqipëri, si praktikë dhe trashëgimi kulturore jomateriale. Aplikohet për t'u siguruar bagëtive ushqim natyror të bollshëm e të shumëllojshëm, në dimër (në kullotat fushore - bregdetare) dhe në verë (në kullotat malore). Karvanët e bagëtive shoqërohen me qen stani (roje) dhe kafshë transporti (mushka dhe /ose kuaj). Procesi kryhet sipas traditave të lashta dhe shoqërohet me ceremoni, rite, valle, këngë mallëngjimi, veshje, shtroja dhe mbuloja, mjete pune dhe orendi kuzhine, instrumente muzikore.</p> <p><i>Transhumance in Albania, as a practice and intangible cultural heritage. It is applied to provide livestock with abundant and varied natural food, in winter (in plain-coastal pastures) and in summer (in mountain pastures). Livestock caravans are accompanied by stable dogs (guards) and transport animals (mules and / or horses). The process is performed according to ancient traditions and is accompanied by ceremonies, rites, dances, songs of longing, clothing, bedding and tablecloths, work tools and kitchen furniture, musical instruments.</i></p>
<p>1.3. Bashkësia (të) përkatëse / Relevant community (s)</p> <p>Komunitetet rurale të Alpeve Perëndimore Shqiptare; Lumës, Korabit dhe Martaneshit; Labinotit, Gjinarit, Shebenikut dhe Polisit, Mokrës, Gorës, Oparit, Voskopojes dhe Gramozit; Tomorricës dhe Dangëllisë; Kurveleshit, vargmaleve Shëndëlli-Lunxheri-Bureto, Trebeshinë-Dhëmbel-Nemërçkë, Konispolit etj.</p> <p>Rural communities of the Albanian Western Alps; Luma, Korab and Martanesh; Labinot, Gjinari, Shebenik and Polis, Mokra, Gora, Opar, Voskopoja and Gramoz; Tomorricës and Dangëllisë; Kurvelesh, Shëndëlli-Lunxheri-Bureto mountain ranges, Trebeshinë-Dhëmbel-Nemërçkë, Konispol, etc.</p>
<p>1.4. Vendndodhja fizike, shtrirja dhe frekuenca e praktikimit të elementit/ Physical location, extent and frequency of practice of the element</p>

- Gramozi (Ersekë), Sharr, Bistra, Konispoli →Çamëri;
- Kurveleshi, Çajupi, Konispoli etj., →Delvinë, Fusha e Vurgut, Vrinë (Sarandë);
- Vargmalet Shëndëlli-Lunxheri-Bureto, Trebeshinë-Dhëmbel-Nemërçkë → Dropull, fushat gjatë rrjedhjes së mesme dhe të poshtme të Vjosës, Delvinë;
- Voskopoja, Tomorrica, Dangëllia, →në Myzeqenë Madhe;
- Kurveleshi → Myzeqenë e Vogël, Vlorë (fushën bregdetare);
- Nga Lumi i Vlorës, Kanina → në Fushën e Korçës;
- Çermenika, Polisi, Shebeniku, Golloborda →fushën e Elbasanit, deri në Myzeqe;
- Alpet Lindore, Hasi dhe Gjallica →Rrafshin e Dukagjinit (Kosovë);
- Alpet Perëndimore →Fushën e Mbishkodrës, Nënshkodrës dhe atë midis Lezhës Tiranës dhe Durrësit;
- Korabi, Luma, Martaneshi → fushën dhe kodrat midis Tiranës, Lezhës e Durrësit, Kavajë, Myzeqe.

Shtegtimi organizohen dy herë në vit: prill-maj në drejtim të kullotave malore; shtator-tetor, në drejtim të kullotave fushore-bregdetare.

- Gramoz (Ersekë), Sharr, Bistra, Konispoli →Çamëri;
- Kurveleshi, Çajupi, Konispoli etc., →Delvinë, Fushë e Vurgut, Vrinë (Sarandë);
- Shëndëlli-Lunxheri-Bureto, Trebeshinë-Dhëmbel-Nemërçkë → Dropull mountain ranges → Dropull, areas along the middle and lower reaches of the Vjosa, Delvinë;
- Voskopoja, Tomorrica, Dangëllia, →në Myzeqenë Madhe;
- Kurveleshi → Myzeqenë e Vogël, Vlora (coastal plain);
- From Lumi i Vlores, Kanina → in the plain of Korça;
- Çermenika, Polisi, Shebeniku, Golloborda →the plain of Elbasanit, up to Myzeqe;
- Eastern Alps, Hasi and Gjallica →Dukagjini Plain (Kosovo);
- Western Alps →The plain of Mbishkodra, Nënshkodra and that between Lezha Tirana and Durres;
- Korabi, Luma, Martaneshi → the field and the hills between Tirana, Lezha and Durrës, Kavaja, Myzeqe.

Transhumance is organized twice a year: April-May in the direction of mountain pastures; September-October, in the direction of plain-coastal pastures.

1.5 Përshkrim i shkurtër i elementit (mundësisht jo më shumë se 200 fjalë)/ Short description of the item (preferably not more than 200 words)

Është e praktikë e jetës baritore. Në sistemin e mbarështimit të bagëtive, tufa zhvendoset midis dy zonave nëpër “shtigje” me distanca të qarta, sipas një ritmi stinor. Tufat shtegtuese mund të varen nga një komunitet i caktuar që jeton në mal, ku kalon verën: apo e anasjellta që nënkupton shtegtimin zbritës dimëror, drejt fushave. Kjo formë dëshmon për një ekonomi malore mjaft të kufizuar ku rezervat e foragjereve janë të pamjaftueshme. Transhuanca zbritëse është karakteristike për hapësirat malore perimesdhetare si Ballkani ku përfshihet edhe Shqipëria. Transhumancat në kah të kundërt (ose ngjitëse) i orienton kopetë mesdhetare drejt malit.

Mund të dallohen dy lloje të transhumancës :

- horizontale, zhvillohet kryesisht në zonat fushore e kodrinore nga ku shtegtojnë barinj të me bagëtitë e tyre, në distanca të gjata, nga kullotat verore larg shtëpive të tyre deri në kullotat dimërore afër shtëpive të tyre (praktikohet në Rajonin Qëndror të Shqipërisë dhe në zonat kodrinore të Rajonit Jugor);
- vertikale, ndodh zakonisht në rajone malore ku kafshët drejtohen në kullota me lartësi të madhe dhe anasjelltas (praktikohet në pjesën malore të Rajonit Jugor dhe Juglindor).

*It is a practice of pastoral life. In the livestock breeding system, the herd moves between two areas through "paths" with clear distances, according to a seasonal rhythm. Migratory herds can depend on a particular community living in the mountains, where they spend the summer: or vice versa, which means descending winter migration to the plains. This form testifies to a rather limited mountain economy where fodder reserves are insufficient. The descending transhumance is characteristic for the mountainous vegetable areas like the Balkans where Albania is included. Transhumance in the opposite direction (or ascending) orient the Mediterranean herds towards the mountain.*

*Two types of transhumance can be distinguished:*

- *horizontal, takes place mainly in lowland and hilly areas from where shepherds migrate with their livestock, over long distances, from summer pastures away from their homes to winter pastures near their homes (practiced in the Central Region of Albania and in hilly areas of the Southern Region);*
- *vertical, usually occurs in mountainous regions where animals are directed to high pastures and vice versa (practiced in the mountainous part of the Southern and Southeastern Region).*

## **2. Karakteristika të elementit / Characteristics of the element**

2.1. Praktikuesi (t)/interpretuesi (t) i përfshirë drejtpërdrejt në përfaqësimin ose praktikimin e elementit (emrertimi, mosha, gjinia, kategoria profesionale etj.)/ Practitioner (s) directly involved in the representation or practice of the element (name, age, gender, professional category, etc.)

Bartësit dhe praktikuesit e elementit janë blegdorët shtegtues/shëtitës (duke përfshirë barinjët/cobanët) bashkë me familjet e tyre dhe tërësinë e pajisjeve, orendive të nevojshme. Cdo pjestar i familjes ka role të vecanta në zhvillimin e veprimtarive përgatitore për nisjen e shtegimit, përgjatë periudhës së lëvizjes dhe gjatë qëndrimit në stan, sigurisht të shoqëruar dhe ndihmuar nga kafshë të tjera si qentë, kuajt e mushkat.

Për të gjithë pjestarët e familjes ka punë specifike sipas moshës dhe mundësive fizike. Të moshuarit burra merren me konceptimin e stanit, gdhendin në dru dhe në kocka. Japin parashikimin e motit dhe flasin për përvojën e tyre. Fëmijët mësojnë, sa mund të mësojnë në këto kushte. Ata njihen me faunën dhe florën e vendit, duke qenë aleatët më të mirë të të moshuarve. Të rinjtë ndihmojnë për ndërtimin e stanit, asistojnë barinjët dhe të gjithë bashkë bëjnë prapavijën në ndihmën e kopesë, që prodhon qingjat, kecat, qumshtin dhe leshin.

Bariu/cobani konsiderohet si figura me rolin kyc. Bariu i kopesë nuk i ndahet bagëtive në çdo kohë: shi, breshër ose borë. Ai vendos shenja dalluese të bagëtive të tij që të mos ngaterrohen me tufa të tjera, gjithashtu u vendos atyre këmborë ë zile të ndryshme dhe nëpërmjet tingujve të tyre arrin t'i menaxhojë më me lehtësi. Bariun, në punën e vet, e ndihmojnë meshkuj të rinj, që do ta zëvendësojnë atë, por ndihmësi kryesor i bariut është qeni i stanit.

*The bearers and practitioners of the element are the migratory herders (including shepherds) together with their families and all the necessary equipment, furniture. Each member of the family has special roles in the development of preparatory activities for the start of the transhumance, during the period of movement and during the stay in the tents, of course accompanied and assisted by other animals such as dogs, horses and mules.*

*There are specific jobs for all family members according to age and physical abilities. Older men deal with the conception of the tent, carving in wood and bone. They give the weather forecast and talk about their experience. Children learn, how much they can learn in these conditions. They get acquainted with the fauna and flora of the country, being the best allies of the elderly. The young men help build the tents, assist the shepherds, and together they make their way to the aid of the flock, which produces lambs, kids, milk, and wool.*

*The shepherd is considered a key figure. The shepherd of the flock is not separated from the cattle in any weather conditions: rain, hail or snow. He places distinctive signs on his cattle so as not to confuse them with other herds, he also places them on different bells and through their sounds he manages them more easily. The shepherd, in his work, is assisted by young men, who will replace him, but the main helper of the shepherd is the tent dog.*

2.2. Njerëz të tjerë në bashkësi që, pa u përfshirë drejtpërdrejt, kontribuojnë në praktikimin e elementit ose lehtësojnë praktikimin dhe transmetimin e tij. / Other people in the community who, without being directly involved, contribute to the practice of the element or facilitate its practice and transmission.

Transhumanca zakonisht praktikohet nga burrat e djemtë e familjeve, në veri të Shqipërisë, kjo praktikë është ende familjare ku përfshihen gratë dhe vajzat. Gjithësesi në cdo rast gratë kanë rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e praktikës. Të gjitha veshjet e stanit kalojnë nga duart e grave. Gjithashtu edhe çadrat provizore prej shajaku, në formë gune. Mbulesat e samarit të kafshëve dhe rripat e samarit, kapistrat e kuajve, tërkuzat, etj, Gruaja gjithashtu kujdeset për përgatitjen e ushqimit të familjes; ka raste që për pak kohë bëhet dhe bareshë. *Stopani* (shënim: në fjalorin shqip kjo fjalë sqarohet: çelnik, stanar, nga tregimet në fshatra nuk është tamam kështu). Stopani merret me përpunimin e bulmetit. Stani është edhe vend konsumi. Aty përpunohet bulmeti për vete, grumbullohen ushqime të tjera dhe përgatitet mishi në mënyra të ndryshme. Është një magazinë dhe stopani mbetet përpunues dhe magazinier.

*Karvanjari* (drejtuesi, menaxhuesi i karvanit) furnizon me bukë barinjët dhe qentë, furnizon dhe me materialet e nevojshme si kripë, ujë të pijshëm dhe gjithçka i duhet bagëtisë dhe njerëzve

*Transhumance is usually practiced by the men and boys, in the north of Albania, this practice still involves women and girls. However, in any case, women have a very important role in the development of practice. All tent dresses pass through the hands of women. Also temporary shajak tents, animal saddle covers and saddle belts, horse harnesses, crossbows, etc. The woman also takes care of the preparation of the family food; there are cases when for a short time they become shepherds too.*

***Stopani** (note: in the Albanian dictionary this word is clarified: çelnik, stanar, from stories in villages it is not exactly like that). Stopani deals with dairy processing of milk and meat.*

***Karvanjari** (leader, caravan manager) supplies food to the shepherds and dogs, supplies the necessary materials such as salt, drinking water and everything the cattle and people need.*

2.3. Gjuha ose regjistri gjuhësor i përdorur/ Language or language register used

Shqipe dhe arumune (në disa komunitete të Shqipërisë së Jugut, si Voskopoja).

*/ Albanian and Aromanian (in some communities of Southern Albania, such as Voskopoja).*

2.4. Elementet materiale (vegla, veshje ose vende specifike, objekte rituale), në rast se ka, të bashkëlidhura me praktikimin e elementit të TKJ / Tangible elements (working tools, clothing or specific places, ritual objects), if any, associated with the practice of the ICH element

Kërraba, armët e zjarrit dhe municioni, armët e ftohta (thika, biçaku); instrumentet muzikore (fyelli, pipëza, lahuta, zumarja, gajdja etj.); guna, kësula prej leshi, opingat prej lëkure dhe veshjet e tjera të barinjve; shtrojat e mbuloja për fjetje; kambanat dhe zilet e bagëtive; shalë, samarë dhe litarë për kafshët e transportit; vedra, kazanë, bidonë, tenxhere, tepsi, mëti për ruajtjet dhe trajtimin e qumështit; napa për kullimin e djathit; shtamba dhe bulira për ujin e pijshëm; lera dhe enë të punuara në trungje druri, ku pinin ujë bagëtitë; dru zjarri dhe orenditë e kuzhinës; çarranik (kabinë druri, e shkëputur nga kasollja dhe rreth 120 cm mbi tokë) për ruajtjen e bulmetit; vendet e posaçme për ruajtjen e kripës për bagëtitë, bazës ushqimore (krunde, misër, tagji), leshit, veglave etj.

*Shepherd's stick, fire weapons and ammunition, cold weapons (knife, switchblade knife); musical instruments (flute, pipe, lute, zumare, bagpipe, etc.); woolen coats and hats, traditional leather shoes (opinga) and other shepherds' clothing; sheetbeds for sleeping; bells and cattle bells; saddles, and ropes for transport animals; wooden containers for different products, kettles, drums, pots, pans, trays for storing and treating milk; cheesecloth for draining the cheese; pitchers and jugs for drinking water; troughs and containers made of wooden logs, where cattle can drink water; firewood and kitchen furniture; çarranik (wooden cabin, detached from the hut and about 120 cm above the ground) for dairy storage; special places for storing salt and food (bran, corn, oats) for livestock, wool, tools, etc.*

2.5. Elemente të tjera jomateriale (në rast se ka) të bashkëlidhura me praktikimin ose përcjelljen e elementit. / Other intangible elements (if any) associated with practicing or accompanying the element.

Historitë, legjendat, gojëdhënat, poezitë dhe këngët dedikuar shtegtimit (p.sh. “Kur më vjen burri nga stani”, “Baresha” etj); ceremonitë në momentin e nisjes dhe të kthimit nga shtegtimi; drekat festive dhe ritet që shoqërojnë qethjen e bagëtive; ritualet lidhur me therjen e bagëtive, rrjepjen, përpunimin dhe konservimin e mishit; pjelljen e bagëtive dhe ndarjen e qengjave/kecave nga mëmat.

*Stories, legends, folklore, poems and songs dedicated to transhumance (eg “When my husband comes from Stan”, “Baresha” ect); ceremonies at the time of departure and return; festive lunches and rites accompanying cattle shearing; rituals related to slaughtering cattle, processing and preserving meat; breeding cattle and separating lambs / kids from mothers.*

2.6. Praktika zakonore (në rast se ka) që rregullojnë qasjen në elementin e TKJ ose në disa aspekte të tij. / Customary practice (if any) governing access to the ICH element or some aspect thereof.

Kanuni i Lek Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut dhe ai i Labërisë janë dokumentet mesjetare që rregullojnë të drejtat zakonore në sektorin e blegtorisë në Shqipëri: statusin e bariut, të tufës, cjamin apo dashit të këmborës, të qenit të tufës; të drejtën e pronës, kufijtë, sistemin e gjysmatarisë; statusin e bjeshkës, kullotës, livadhit, pyllit (i përbashkët për komunitetin), mrrizit dhe stanit; mënyrat e shlyerjes së dëmit; statusin e udhës së fshatit dhe të shtegut të bagëtive etj.

*The Kanun of Lek Dukagjini, the Kanun of Skanderbeg and that of Labëria are medieval documents that regulate customary rights in the livestock sector in Albania: the status of shepherd, herd, the bell's goat or ram; property rights, boundaries, equal gain system; the status of mountain, pasture, meadow, forest (common to the community), mrriz and stan; ways of compensating the damage; the status of the village road and the cattle path, etc.*

2.7. Mënyrat e përcjelljes së elementit të anëtarët e tjerë të bashkësisë. Ways of transmitting the element to other members of the community.

- Verbalisht, përmes shpjegimit të përsëritur të praktikave, që nga fëmijëria.
- Përmes angazhimit drejtpërdrejt në proces (ekipi i barinjve me përvojë pranon çdo vit të rinj që dëshirojnë të shoqërojnë tufat në shtegtim).
- Rol ka edhe tradita familjare apo e komunitetit, e cila përcillet tek të rinjtë nëpërmjet rrëfenjave të gjyshërve, pleqve të fisit e të fshatit, dorëshkrimeve, librave dhe materialeve të tjera.
- *Verbally, through repeated explanation of practices, since childhood.*
- *Through direct involvement in the process (the team of experienced shepherds receives young people every year who want to accompany the herds on transhumance).*
- *Family or community traditions also play a role, which is passed on to young people through the stories of grandparents, tribal and village elders, manuscripts, books and other materials.*

2.8. Organizatat përkatëse (organizata të bashkësive, OJF të tjera) / Relevant organizations (community organizations, other NGOs)

- OJF-të (p.sh. *RURAL*, Shtëpia e Bariut) që kanë në fokus botën rurale dhe blegtorinë në veçanti.
- Shkollat e mesme me profil bujqësor dhe blegtoral.
- Mediat, në disa raste, kanë ndikim informues dhe sensibilizues, lidhur me ruajtjen dhe zhvillimin e praktikave blegtorale si shtegtimi, me vlera të spikatura ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore.
- *NGOs (eg *RURAL*, *Shepherd House*) that focus on the rural world and livestock in particular.*
- *High schools with agricultural and livestock profile.*
- *The media, in some cases, have an informative and sensitizing impact, regarding the preservation and development of livestock practices such as transhumance, with outstanding economic, social, cultural and environmental values.*

**3. Gjendja e elementit të TKJ : qëndrueshmëria / Condition of the ICH element: sustainability**

3.1. Rreziqet e mundshme ndaj praktikimin të vijueshëm të elementit në gjirin e bashkësive përkatëse. / Potential risks to the continued practice of the element within the respective communities.

Praktika e shtegtimit është ruajtur dhe zhvillohet në mënyrë **të qëndrueshme**, e favorizuar nga lehtësitë që ofrojnë arritjet bashkëkohore: informacioni i shpejtë e i saktë për motin, gjendjen e kullotave, rezervat e ujit; kushtet më të mira të jetesës dhe punës për barinjtë; komunikimi i shpejtë e i saktë përmes telefonit celular, internetit dhe rrjeteve sociale; ruajtje në kushte frigoriferike, transport dhe tregtim i garantuar i produkteve blegtorale.

Si **rreziqe** për vijueshmërinë mund të shihen:

- rënia e interesit të të rinjve për blegtorinë;
- largimi i fuqisë punëtore nga fshati;
- shtimi i subjekteve blegtorale me regjim stallor (blegtoia intensive);
- financimi i pamjaftueshëm i sektorit të blegtorisë ekstensive.

The practice of transhumance is maintained and developed in a sustainable way, favored by the facilities offered by modern achievements: fast and accurate information about the weather, the condition of the pastures, water reserves; better living and working conditions for shepherds; fast and accurate communication via mobile phone, internet and social networks; refrigerated storage, transport and guaranteed trade of livestock products.

Risks for the for ongoing development can be:

- Decreased interest of young people in livestock;
- leaving of the labor force from the village;
- increase of intensive livestock regime;
- insufficient funding of the extensive livestock regime.

3.2. Rreziqet e mundshme ndaj përcjelljes së elementit në bashkësinë përkatëse. / Potential risks to the transmission of the element to the relevant community.

- Ndërprerja, në disa raste, e vazhdimësisë dhe e komunikimit ndërmjet gjeneratave (migrimet brenda dhe jashtë vendit, mungesa e pasardhësve meshkuj ...).
- Motivimi dhe kooperimi, në disa raste, i pamjaftueshëm.
- Ftohja e marrëdhënieve brenda komunitetit.
- *Interruption, in some cases, of continuity and communication between generations (migrations inside and outside the country, lack of male offspring ...).*
- *Motivation and cooperation, in some cases, insufficient.*
- *General cooling down relationships within the community.*

3.3. Rreziqet që ndikojnë në qasjen e vijueshme ndaj elementeve materiale dhe burimeve bashkëlidhur me elementin e TKJ. / Risks affecting the continuing access to tangible elements and resources associated with the ICH element.



Qëndrueshmëria e elementëve materialë (interesi ekonomik) përcakton në një masë të madhe qëndrueshmërinë e TKJ-së. Me rëndësi për qëndrueshmërinë e TKJ-së janë:

- Ndryshimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik dhe social-kulturor në komunitetet blegtorale (mundësi punësimi me paga më të larta në industri, ndërtim dhe sektorin terciar).
- Reduktimi i kontingjenti të fuqisë punëtore blegtorale dhe i popullsisë (si konsumatore e produktit dhe si riprodhuese e gjeneratave të reja të blegtorëve në mjedisin ku aplikohet praktika e shtegtimit).
- Pamjaftueshmëria e kapaciteteve përpunuese të produktit blegtoral të tufave të bagëtive shtegtuese.
- Mungesa, në disa raste, e mjeteve frigoriferike të transportit të prodhimeve blegtorale.
- Pasiguria lidhur me çmimet dhe shitjen e produkteve blegtorale.

The sustainability of tangible elements (economic interest) largely determines the sustainability of this ICH. Important for the sustainability of ICH are:

- Changing the priorities of economic and socio-cultural development in livestock communities (employment opportunities with higher wages in industry, construction and tertiary sector).
- Reduction of the contingent of livestock labor force and population (as a consumer of the product and as a producer of new generations of farmers in the environment where the practice of migration is applied).
- Insufficiency of processing capacities of the livestock product of transhumant herds.
- Lack, in some cases, of refrigerated means of transporting livestock products.
- Uncertainty regarding prices and sales of livestock products.

3.4. Qëndrueshmëria e elementeve të tjera të TKJ, të bashkëlidhura me transhumancën./ Sustainability of other elements of ICH, attached to the practice of Transhumance.

- Folklori tradicional (këngë, valle, zakone, tradita, legjenda, rite, mite, fabula, histori, proverba, gojëdhëna, përralla, besime, besëtytni, gjëgjëza etj.), i lidhur ngushtë me shtegtimitin, element i TKJ-së, ruhet disi më mirë në komunitetet rurale të zonave malore, por është zbehur në territoret që janë më të ekspozuara nga efektet e urbanizimit dhe modernizimit.
- Profesione në funksion të shtegtimitit, të cilat mishërojnë elemente të krijimtarisë artistike, si: endja në vegjë e shtrojave dhe mbulojave, thurja e veshjeve tradicionale, qëndisja apo punimi me grep, gdhendja e enëve prej druri, metali, guri, balte etj., thurja me thupra e shportave, koshave dhe orendive të tjera, janë konkurruar nga industria dhe ruhen me vështirësi në mjediset rurale të territoreve malore.
- Traditional folklore (songs, dances, customs, traditions, legends, rites, myths, fables, stories, proverbs, folklore, tales, beliefs, superstitions, riddles, etc.), closely related to the transhumance, an element of ICH is preserved somewhat better in rural communities of mountainous areas, but has faded in territories that are more exposed to the effects of urbanization and modernization.
- Professions in the function of transhumance, which embody elements of artistic creativity, such as: weaving of bedspreads and bedcovers, knitting traditional clothes, embroidery or crochet, carving wooden, metal, stone, clay, etc. The wicker weaving of baskets, hampers and other furniture has been competed by industry and is difficult to maintain in the rural areas of the mountainous territories.

3.5. Masa të mbrojtjes ose të tjera masa të ndërmarra për të përballuar këto rreziqe dhe për të nxitur praktikimin dhe përcjelljen e elementit të TKJ në të ardhmen. / Safeguarding or other measures taken to address these risks and to encourage the practice and follow-up of the ICH element in the future.

- Promovim i vlerave të TKJ nga institucionet shtetërore dhe vendore.
- Projekti “100 fshatrat”, që synon të përmirësojë infrastrukturën, urbanistikën dhe peizazhin e vendbanimeve rurale me potencial turistik.
- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Rural.
- Programi Kombëtar i Zhvillimit të Agroturizmit dhe Turizmit Rural.
- Ruajtja e tarifave të ulëta për shfrytëzimin e kullotave.
- Përpjekje për përmirësimin e kushteve të jetesës në stane (furnizimi me energji elektrike, ujë të pijshëm, internet).
- Subvencionimi dhe kreditimi të subjekteve blegtorale që aplikojnë shtegtimin.
- Garantimin e çmimeve motivuese dhe i tregtimit të produktit të tufat shtegtuese.
- Sensibilizimi i opinionit publik lidhur me rëndësinë e ruajtjes dhe zhvillimit të praktikave të shtegtimin dhe të gjithë elementeve mbështetëse.
- Ofrimi i shërbimeve veterinarë në terren.
- Paga motivuese për barinj të punësuar (shpërblime për më të mirët) dhe gjithë profesionistët e tjerë, të lidhur më praktikën e shtegtimin.
- Organizimi i kurse trajnuese për barinj të që dëshirojnë të aplikojnë blegtorinë shtegtuese.
- Krijimi dhe forcimi i drejtimit “Blegtori” në shkollat e mesme bujqësore të vendit.

- *Promotion of ICH values by state and local institutions.*
- *The project "100 villages", which aims to improve the infrastructure, urban planning and landscape of rural settlements with tourist potential.*
- *National Rural Development Strategy.*
- *National Program for the Development of Agrotourism and Rural Tourism.*
- *Maintaining low tariffs for pasture use.*
- *Efforts to improve living conditions in tents (electricity supply, drinking water, internet).*
- *Subsidizing and lending to livestock entities that practice transhumance.*
- *Guaranteeing motivational prices and marketing of the product of transhumant herds.*
- *Awareness of public opinion regarding the importance of maintaining and developing transhumant practices and all supporting elements.*
- *Providing veterinary services in the field.*
- *Motivational salary for employed shepherds and all other professionals, related to the practice of transhumance.*
- *Organizing training courses for shepherds who want to apply transhumant livestock.*
- *Establishment and strengthening of the "Livestock" profile in the agricultural high schools of the country.*

#### **4. Kufizimet dhe lejet për të dhënat / Restrictions and permissions on data**

4.1. Dakordësia dhe pjesëmarrja e bashkësisë (ve) në mbledhjen e të dhënave. / Consent and participation of the community (ies) in data collection.

Për mbledhjen e të dhënave për këtë dokument janë kryer takime, konsultime, intervista me familje të komuniteteve baritore në gjithë territorin e Shqipërisë, por duke u fokusuar fillimisht në dy zona si ajo e Rajonit Jugor e Juglindor dhe atij Verior e Verilindor. Gjithësesi procesi i konsultimit me komunitetin do të vazhdojë deri në përfshirjen ezauruese të gjithë familjeve praktikuese të shtegtimit.

*For the collection of data for this document, meetings, consultations, interviews with families of pastoral communities were conducted throughout the territory of Albania, but initially focusing on two areas such as the Southern and Southeastern Region and the North and Northeast. However, the community consultation process will continue until the exhaustive involvement of all transhumant families.*

4.2. Kufizimet në përdorimin dhe qasjen ndaj të dhënave. / Restrictions on the use and access to data

Problemi kryesor i hasur ka qenë mungesa e statistikave zyrtare lidhur me familjet që praktikojnë shtegtimin, për rrjedhojë ka qenë e nevojshme takimi nga afër i praktikuesve të transhumancës.

*The main problem encountered was the lack of official statistics regarding families practicing transhumance, so close meetings with transhumance practitioners was necessary.*

4.3. Persona burimi të informacionit : emri, statusi ose përkatësia.

Bashkëlidhur këtij dokumenti, tabelat me kontaktet e praktikuesve të transhumancës të kontaktuar.

*Attached to this document, tables with contacts of contacted transhuman practitioners.*

4.4. Data dhe vendi i mbledhjes së të dhënave

Bashkëlidhur

Atteched

**5. Referenca në lidhje me elementin (në rast se ka) / References regarding the element (if any)**

5.1. Literatura

Bibliography (if any)

1. Barbarich, E. (1905). "Albania", Rome, pg 225-230
2. Duselier, A. (1980). La façade maritime de l'Albanie au Moyene age,
3. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, ASHSH, 2009, pg 2627
4. Foto, I. (2005) Çelnicët e Jugut, Tiranë
5. Foto, I. (2008) Çelnicët shtrydhën malet, Tiranë
6. Hahn, J.G.V. (1954). Albanesische Studien, Jena, pg 15-16; 50
7. Haxhiu, F. (1963). Koperativa blegtorale – bujqesore
8. Haxhiu, F. (1963-1964). Ekspedita etnografike e Laberise (pg 1-3, 25, 95-97)
9. Haxhiu, F. (1963-1964). Materiale te Laberise
10. Haxhiu, F. et al. (1963). Etnografia shqiptare, pg 3-49
11. Historia e Bujqësisë dhe agroindustrisë shqiptare – Grup autorësh, fq 290, Tiranë, KEA 2013
12. Historia e Shqiperise Vol. I, Akademia e Shkencave
13. Journal "Bujqesia", (1930), no. 9 (pg. 44-45), no. 11 (pg. 48-50), no. 12 (pg 39)
14. Journal "Ekonomisti shqiptar" (1932), no. 2, pg 39-40
15. Kanunnameja e Livase se Vlores 1583 ne: Burime te zgjedhura per Historine e Shqiperise III, (1962)
16. Laci, S. (2013) Gjeografia Humane e Shqiperise, LILO, Tirane
17. Laci, S. et al (2011) Gjeografia Rurale, LILO, Tirane
18. Mustakidhis, N. (1904). Epirotikos Astir. (Taken from the archive of I. H "Historiku i Himares), pg. 272-275
19. Pastoral tradition in the Sharr / Korab-Koritnik range - Study under the Open Regional Funds for South East Europe program - Implementation of Biodiversity Agreements and funded by GIZ
20. Shpuza, S. "Aspekte të ekonomisë antike Ilire dhe Epiriote", ILIRIA Nr. XXXIV
21. Sufflay, M (1926). Serbet dhe Shqiptaret, pg 94-95
22. Tirta, M (1999). Migrime te shqiptareve
23. Tirta, M. (2003, 2006). Etnologjia e Shqiptareve
24. Zeneli, A. (1964). Etnografia shqiptare 2

5.2. Materiale audiovizuale, regjistrim etj, të ruajtura në arkiva, muzeume dhe koleksione private (nëse ka).

<http://aqshf.gov.al/?movie=292&lng=ikgcmaehxv>

<https://www.visit-gjirokastra.com/the-tradition-of-herds-migration-in-gjirokastra/?lang=sq>

[https://www.youtube.com/watch?v=EhHoM\\_AJ8Ys](https://www.youtube.com/watch?v=EhHoM_AJ8Ys)

<https://veterineret.com/per-dashamiresit-dhe-pronaret/kafshet-e-fermave-blegtoria/rituali-shtegetime-shqiptare/>

<https://www.botasot.info/shqiperia/1109833/shtegtimi-i-bagetive-tradita-shekullore-vijon-edhe-ne-elbasan/>

[https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/STRATEGJIA\\_NDERSEKTORIALE.pdf](https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/STRATEGJIA_NDERSEKTORIALE.pdf)

(faqe 8532)

[http://seerural.org/1documents/Events/Other\\_events/Presentations\\_SBD\\_2007/QENDRA\\_E\\_TRANSFERIMIT\\_TE\\_TEKNOLOGJIVE\\_BUJQESORE.pdf](http://seerural.org/1documents/Events/Other_events/Presentations_SBD_2007/QENDRA_E_TRANSFERIMIT_TE_TEKNOLOGJIVE_BUJQESORE.pdf)

[http://see.efncp.org/download/HNVF\\_SEE\\_Albania.pdf](http://see.efncp.org/download/HNVF_SEE_Albania.pdf)

[http://akzm.gov.al/wp-content/uploads/2020/02/Studimi\\_ZM\\_Draft\\_Dhjetor\\_2019.pdf](http://akzm.gov.al/wp-content/uploads/2020/02/Studimi_ZM_Draft_Dhjetor_2019.pdf)

5.3. Materiale dokumentare dhe objekte të ruajtura në arkiva, muzeume dhe koleksione private (nëse ka).

## 6. Të dhënat e inventarit

6.1. Emri i personit (ve) që kanë përpiluar të dhënat në inventar.

### **RUR.AL**

Rr. Ismail Qemali, ND.29 Vlore  
Esmeralda Laci – Executive Director  
+355693576076  
[info@rural.al](mailto:info@rural.al); [es\\_laci@yahoo.com](mailto:es_laci@yahoo.com)

Institute for Rural Research  
Zef Gjeta  
Rr. Muhamet Gjollesha Tirane  
+355 682038266  
[ruralresearch@mail.org](mailto:ruralresearch@mail.org)

6.2. Prova e dhënies së pëlqimit nga bashkësitë përkatëse : (a) për inventarizimin e elementit dhe (b) për informacionin që do të përfshihet në inventar.

Evidence of consent given by the respective communities: (a) for the inventory of the item and (b) for the information to be included in the inventory.

Firmat bashkelidhur

Attached

6.3. Data e regjistrimit të të dhënave në inventar./

Date of registration of data in the inventory

--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE JOMATERIALE

Nr. 191 Prot.

Tiranë, më 30/07/2020

VENDIM

Nr. 2, datë 30.07.2020

“PËR

**KANDIDIMIN PËR REGJISTRIM NË “LISTËN E PËRFAQËSUESE TË  
DUKURIVE TË TRASHËGIMISË JOMATERIALE TË NJERËZIMIT TË  
UNESCO-S” TË 4 DUKURIVE TË TRASHËGIMISË JOMATERIALE,  
KRYEVLERA KOMBËTARE TË TRASHËGIMISË KULTURORE  
JOMATERIALE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës, Ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, neni 39, pika g; të Konventës së UNESCO-s “ Për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore jomateriale” 2003; si dhe miratimit unanimit të antarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (KKTKJ), i ngritur sipas VKM nr.209, datë 10.04.2019, “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e antarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”, pas shqyrtimit të propozimeve, të bëra në mbledhjen e KKTKJ-së dt. 30.07.2020, për kandidim për regjistrim në “Listën Përfaqësuese të Dukurive të Trashëgimisë Jomateriale të Njerëzimit të UNESCO-s, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale,

**VENDOSI:**

Miratimin e kandidimit për regjistrim në “Listën Përfaqësuese të Dukurive Trashëgimisë Jomateriale të Njerëzimit” të UNESCO-s të dukurive të trashëgimisë jomateriale, kryevlera kombëtare të trashëgimisë kulturore jomateriale si më poshtë:

1. “*Kçimi i Tropojës*”. Folklor koreografik. Tipologji e trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare.

2. “*Rituali i lashtë i shtegëtimit të bagëtive*”. Ritual shumë i vjetër i shtegëtimit të bagëtive drejt maleve, zhvillohet kryesisht në shumë zona nga veriu në jug të Shqipërisë. Dukuri e trashëgimisë kulturore jomateriale, ritual tradicional.

3. “*Xhubleta si teknologji dhe diçebërje artizanale dhe të formave të përdorimit të saj- “Kçimi i Logut”, etj.*”. Dukuri unikale në dukurinë e punimit artizanal në Veriun e Shqipërisë.



4. "Eposi i Kreshnikëve i kënduar dhe shoqëruar me lahutë". Folklor vokal, instrumental dhe koreografik. Tipologji të trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare.

5. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet sekretaria teknike e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale për njoftimin e këtij vendimi dhe zbatimin e afateve të vendosura.

7. Ky vendim shpallet sot më datë 30.07.2020

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**KRYETAR**

**ELVAMARGARITI**



**SEKRETARIA TEKNIKE**

**Niko Kotherja**



Republic of Albania  
Ministry of Culture  
National Council of Intangible Cultural Heritage

No. 191 Prot

Tirana, on 30/07/2020

## DECISION

No. 2, date 30.07.2020

"For the nomination for the registration in the "Representative List of the Intangible Heritage of Humanity" of UNESCO, of four elements of the intangible heritage, national masterpieces of the intangible cultural heritage"

Pursuant to point 4 of article 102 of the Constitution, Law no. 27/2018 "On cultural heritage and museums", article 39, letter g; to the UNESCO "Convention for the Safeguarding of the Intangible Cultural Heritage", 2003; as well as the unanimous approval of the members of the National Council of Intangible Cultural Heritage (NCICH), established by the Decision of the Council of Ministers (DCM) no. 209, dated 10.04.2019, "On the composition, mode of operation, competences and remuneration of the members of the National Council of Intangible Cultural Heritage", after consideration of the proposals, made at the meeting of the NCICH dated 30.07.2020, for the nomination or registration in the "Representative List of the Intangible Heritage of Humanity" of UNESCO, National Council of Intangible Cultural Heritage

### Decided:

The approval of the nomination for registration in the "Representative List of the Intangible Heritage of Humanity" of UNESCO, of the intangible heritage elements, national masterpieces of intangible cultural heritage as follows:

1. "*K'cimi i bjeshkës me tupan i Tropojës*". Choreographic folklore. Typology of the Albanian national intangible heritage.
2. "*Rituali i lashte i shtegtimit te bagtive*" (The ancient ritual of transhumance). A very old ritual of livestock droving to the mountains, which takes place in many areas from the North to the South of Albania. It is a phenomenon of intangible cultural heritage, traditional ritual.
3. "Xhubleta si teknologji dhe dijeberje artizanale unikale dhe te formave te perdorimit te saj.. A unique phenomenon in the tradition of handicraft to the North of Albania.
4. "*Eposi i Kreshnikëve i kënduar dhe shoqëruar me lahutë*". Vocal, instrumental and choreographic folklore. Typology of the Albanian national intangible heritage.

5. The ministry responsible for the cultural heritage and the National Council of Intangible Cultural Heritage are in charge for the implementation of this decision.
6. The Technical Secretariat of the National Council of Intangible Cultural Heritage is in charge for the notification of this decision and the implementation of the settled deadlines.
7. This decision is announced today on 30.07.2020.

This decision shall enter into force.

CHAIRWOMAN  
ELVA MARGARITI

TECHNICAL SECRETARIAT  
NIKO KOTHERJA